




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT EPSA SHPK



Nr. 135 Prot

Tiranë, më 15.01.2024

Nr. 22 Dosje

URDHËR

PËR HEQJEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar: **QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT**

TIRANË

Unë, **Julian Ahmeti**, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, pranë Zyrës së Përmbarimit Privat **"EPSA" SHPK**, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Nr.1504 Akti të lëshuar më datë 16.09.2019 prej Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr.22, Datë 03.03.2020 kërkesën e kreditorit **"Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore"** ndaj debitorit **Shoqëria "Egi-K" SHPK**, në lidhje me titullin ekzekutiv "Vendimi Administrativ Nr.8174/1 Prot. date 22.09.2016".

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorëve Lajmërimin Nr. 623 Prot, Datë 04.03.2020, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit Nr.1504 Akti të lëshuar më datë 16.09.2019 prej Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOVA Se :

Se Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me Vendimin Nr.2875 Vendimi, date 10.11.2020 ka shpallur të pavlefshëm titullin ekzekutiv "Vendimi Administrativ Nr.8174/1 Prot. date 22.09.2016".

Në keto kushte në referim të nenit 527, 560, 563 të K.Pr.Civile dhe nenit 32 pikat (b,c,ç) të ligjit Nr. 26/2019 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat",

KËRKOJ

1-Qendra Kombëtare e Biznesit Tiranë, brenda 10-ditësh nga marrja dijani, të kryejë veprimet për heqjen e blokimit e kuotave/aksioneve dhe e të drejtave që rrjedhin nga zotërimi i kuotave te kerkuar me shkresen Nr.2058 Prot. Date 08.07.2020., , per debitorin:

- Shoqëria “Egi-K” SHPK, përfaqësuar nga Z.Eduart Keta, në cilësinën e Administratorit, me NIPT: K77424401L

2- Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

3- Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen në bazë të nenit 606 të K.Pr.Civile (parag.II) që parashikon vendosjen e sanksionit të gjobës dhe kallzimin penal.

ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT “EPSA” SHPK

Përmbaruesi GJYQËSOR

JULIAN AHMETI

